

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI"
MITROVICË



ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË

Raport përbledhës për
pyetësorët e realizuar
me studentët e
Fakultetit Juridik

NIVELI BACHELOR
(Semestri dimëror)
Shkurt, 2022



ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
Hyrja	4
Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC).....	5
Realizimi i pyetësorit	5
Gjetjet e pyetësorit.....	6
Rekomandimet	19

ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË

Lista e shkurtësave

- IAL: Institucion i Arsimit të Lartë
- KQSCV: Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit
- SEVC: Sistemi Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë
- SMU: Sistemi i Menaxhimit Universitar
- UIBM: Universiteti “Isa Boletini” Mitrovicë
- ZSC: Zyra për Sigurim të Cilësisë

Hyrja

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (këtu e tutje: UIBM), si Institucion i Arsimit të Lartë (Këtu e tutje: IAL) themeluar që nga viti 2013, vazhdimisht ka bërë përpjekje që të bëjë të matshëm procesin e sigurimit të cilësisë. Për çdo vit, në UIBM janë organizuar pyetësorë me studentët dhe akterë tjerë relevant, të cilët janë përgjigjur në pyetjet të cilat kanë pasur për qëllim të tregojnë gjendjen reale në UIBM përmes përceptimit të respondentëve.

UIBM ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë, dhe përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanëve, prodekanëve, koordinatorëve për cilësi në kuadër të fakulteteve, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Universitetin “Isa Boletini” (Këtu e tutje: ZSC) ka një rol të veçantë në këto zhvillime, dhe është organi kryesor brenda UIBM për matjen e cilësisë së brendshme.

Në muajin Janar 2022, në vazhdën e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda UIBM, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në UIBM, përmirësimit të mësimdhënies si një proces vazhdimisht i ndryshueshëm përkitazi me metodologjitet e reja, dhe rritjes së përgjegjësisë së stafit menaxhues, ZSC-ja ka realizuar pyetësorin me studentët e Fakultetit Juridik të UIBMsë, në nivelin Bachelor, në përfundim të semestrit dimëror, si një proces tashmë i zakonshëm.

I gjithë procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit.

Më poshtë, do të paraqesim të dhënat që janë nxjerrë nga pyetësori. Me qëllim që raporti të ruaj etikën e secilit dhe atë të institucionit, do të gjeni të publikuara vetëm disa nga gjetjet kryesore të pyetësorit. Rekomandimet si pjesa e fundit e tij, do të përmbajë edhe sygjerime e vërejtje të cilat nuk bëhen publike, por që janë dhënë nga ana e respondentëve.

Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)

Zyra për Sigurim të Cilësisë është zyrë e pavarur e cila funksionon brenda Rektoratit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (tutje UIBM) e cila raporton drejtpërdrejt te Rektori i UIBM-së. ZSC angazhohet në rritjen e cilësisë në UIBM duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentat matës të cilësisë të aprovuar nga Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit (tutje KQSCV). Zyrtarët e cilësisë nuk janë pjesë e stafit akademik të UIBM.

Zyra kryen matje të cilësisë duke përdorur të gjitha instrumentet e përfshira në pakon e instrumenteve matëse të cilësisë e aprovuar nga KQSCV. ZSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilin pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Rektori i UIBM-it. Zyra gjithashtu i dërgon gjetjet dekanëve të njësisive akademike me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Realizimi i pyetësorit

Pas përfundimit të ligjëratave dhe ushtrimeve për semestrin dimëror 2022, ZSC ka lansuar pyetësorin me të gjithë studentët e nivelit bachelor në Fakultetin Juridik, nga data 05 Janar deri me 28 Janar 2022. Pyetësori ka qenë anonim dhe të dhënët janë mbledhur dhe ruajtur nga ZSC përmes Sistemit Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë - SEVC. Studentët janë përgjigjur përmes Sistemit të Menaxhimit Universitar (tutje SMU) në pyetësorin i cili ka përmbajtur 22 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur, ku kanë vlerësuar mësimdhënien, lëndën dhe burimet.

Pyetësori ka qenë i ndarë në dy nivele:

- Cilësia e mësimdhënies dhe stili i mësimdhënies
- Lënda dhe burimet

Pjetjet kanë pasur për qëllim që të shohin këto aspekte kryesore:

- Qasjen e mësimdhënësve ndaj studentëve;

- Mësimin online;
- Sjelljen e mësimdhënësve;
- Vlerësimin e studentëve;
- Rezultatet e të nxënës.

Gjetjet e pyetësorit


Pyetësori është plotësuar nga të gjithë studentët që kanë paraqitur provimet në afatin e rregullt të provimeve, në Fakultetin Juridik, niveli Bachelor. ZSC ka shpërndarë pyetësorin për të gjithë stafin akademik të Fakultetit Juridik dhe kemi marrë 1171 përgjigje nga studentët, ku pjesëmarrja e studentëve në pyetësorë konsiderohet shumë e kënaqshme.

Nga të gjeturat studentët kanë qenë të sinqertë në përgjigjet e tyre, dhe kemi pranuar shumë komente dhe sugjerime që tregon interesimin e tyre që të kontribuojnë në proceset në UIBM.

Ky raport shprehë statistikat e përgjithshme, dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve në nivel të fakultetit si dhe për secilin profesor. ZSC dërgon gjetjet tek Dekanët e fakulteteve, dhe ata këto të gjetura do t'i diskutojnë me stafin e tyre akademik.


Diagrami në vijim, shprehë në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me materialin e ligjëratave dhe ushtrimeve, të përdorur gjatë semestrave dimëror të vitit akademik 2021/2022, ku më shumë se gjysma e studentëve kishin vlerësuar maksimalisht, pak më shumë se një e katërt kishin vlerësuar me mirë, pak më shumë se një e dhjeta mesatarisht dhe një një numër i vogël kishin vlerësuar me jo mirë dhe aspak mirë. Në përgjithësi, mund të themi se shumica e studentëve kishin dhënë vlerësim pozitiv lidhur me materialet e përdorura gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve për semestrin dimëror 2021/2022.

1. Materiali i ligjëratave dhe ushtrimeve ishte i qartë




Diagrami i dytë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me metodat e mësimdhënies gjatë semestrit dimëror të vitit akademik 2021/2022, ku pak më shumë se gjysma e studentëve kanë dhënë vlerësimin më të lartë lidhur me metodat e mësimdhënies, pak më pak se një e treta anë vlerësuar metodat me mirë, një e dhjeta mesatarisht, një pjesë e vogël e studentëve kishin vlerësuar me mirë dhe aspak mirë. Në përgjithësi mund të themi se shumica e studentëve kanë vlerësuar pozitivisht metodat e mësimdhënies gjatë semestrit dimëror 2021/2022.

2. Metodat e mësimdhënies kanë qenë bashkëkohore




Diagrami në vijim, i treti me rradhë tregon përgjigjet e studentëve lidhur me përgatitjen e mësimdhënësve gjatë semestrit dimërор të vitit akademik 2021/2022. Më shumë se gjysma e studentëve kanë dhënë vlerësimin maksimal, një e katërtë kanë vlerëuar me mirë, një e dhjeta mesatarisht dhe një pjesë e vogël e studentëve kishin vlerëuar me jo mirë dhe aspak mirë. Në përgjithësi, në bazë të rezultateve mund të themi se mësimdhënësit kanë demonstruar njohuri të materies së lëndës.

3. Mësimdhënësi/ja demonstron njohuri të materies së lëndës




Diagrami i katërt shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me reportin ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të lëndës. Më shumë se gjysma e studentëve kanë dhënë vlerësimin më të lartë se rapporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të lëndës ka qenë adekuat, një e katërtë janë përgjigjur me mirë, më pak se një e pesta mesatarisht dhe një përqindje e vogël ishin përgjigjur me jo mirë dhe aspak mirë. Në përgjithësi, në bazë të përgjigjeve të shumicës së studentëve mund të themi se rapporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të lëndës ishte adekuat.

4. Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të lëndës ka qenë adekuat




Tutje, diagrami i pestë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me ndërveprueshmërinë e ligjëratave dhe ushtrimeve gjatë semestrit dimëror të vitit akademik 2021/2022. Më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar me shumë mirë ndërveprueshmërinë e ligjëratave dhe ushtrimeve, më shumë se një e katërt kanë vlerësuar me mirë, një e dhjeta mesatarisht dhe një numër i vogël i studentëve janë përgjigjur me jo mirë dhe aspak mirë. Në bazë te rezultateve mund të themi se rezultatet dhe ushtrimet kanë qenë ndërvepruese gjatë semestrit dimëror 2021/2022.

5. Ligjëratat dhe ushtrimet kanë qenë ndërvepruese




Në vijim diagrami i gjashtë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me pyetjen nëse shembujt që ka sjellë mësimdhënësi/ja kanë qenë të lidhur me teorinë e mësuar, ku gati gjysma e studentëve kanë dhënë vlerësimin maksimal, gati një e katërta kanë vlerësuar me mirë, gati një e dhjeta mesatarisht dhe një numër i vogël janë përgjigjur me jo mirë dhe aspak mirë. Në përgjithësi rezultatet tregojnë se shembujt e sjellur nga mësimdhënësit kanë qenë të lidhur me teorinë e mësuar.

6. Shembujt që ka sjellë mësimdhënësi/ja kanë qenë të lidhur me teorinë që kemi mësuar




Diagrami i shtatë në vijim shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndës, ku më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar maksimalisht, më shumë se një e katërta me mirë, një e dhjeta mesatarisht dhe një numër i vogël i studentëve janë përgjigjur me jo mirë dhe aspak mirë. Në përgjithësi mund të themi se shumica e studentëve janë të kënaqur me përmbajtjen e lëndëve.

7. Në përgjithësi jam i/e kënaqur me përbajtjen e lëndës



Tutje, diagrami në vijim shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me vlerësimin e aktiviteteve sipas syllabusit të lëndës, ku më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar me shumë mirë, një e katërta me mirë, një e dhjeta mesatarisht dhe një një numër i vogël i studentëve me jo mirë dhe aspak mirë. Në përgjithësi mund të themi se aktitvititetet si testet, ushtrimet, detyrat, projektet, punimi seminarik etj, janë vlerësuar ashtu si ka qenë e paraparë në syllabusin e lëndës.


8. Aktivitetet (testet, ushtrimet, detyrat, projektet, punimi seminarik etj.) janë vlerësuar ashtu si ka qenë e paraparë në syllabusin e lëndës



Diagrami i nëntë me rradhë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me ndërlidhshmërinë e ligjératave me ushtrimet, ku më shumë se gjysma kanë dhënë vlerësimin maksimal, më shumë se një e


katërta me mirë, gati një e dhjeta mesatarisht dhe një numër i vogël i studentëve kanë vlerësuar me jo mirë dhe aspak mirë. Në bazë të rezultateve mund të themi se ligjëratat kanë qenë të ndërlidhura me ushtrimet.

9. Ligjëratat kanë qenë të ndërlidhura me ushtrimet




Diagrami i dhjetë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me lehtësinë e qasjes në klasat e mësimit online në SMU, ku pak më shumë se dy të pestat e studentëve kanë vlerësuar me shumë mirë, pak më shumë se një e katërta kanë vlerësuar me mirë, gati një e pesta mesatarisht dhe një numër i vogël i studentëve kanë vlerësuar me jo mirë dhe aspak mirë. Në përgjithësi, në bazë të shumicës së studentëve të cilët kanë vlerësuar pozitivisht mund të themi se qasja në klasat e mësimit online në SMU ka qenë e lehtë.

10. Qasja në klasat e mësimit online në SMU ka qenë e lehtë



Në vijim diagrami i njëmbëdhjetë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me pyetjen nëse ligjératat online kanë zhvilluar njejtë aftësitë me ligjératat e mbajtura fizikisht, ku gati dy të pestat kanë vlerësuar me shumë mirë, pak më shumë se një e pesta me mirë, një e pesta mesatarisht një numër i vogël kanë vlerësuar me jo mirë dhe një e dhjeta aspak mirë. Në përgjithësi, mund të themi se më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar pozitivisht se ligjératat online kanë zhvilluar njejtë aftësitë në krahasim me ligjératat e mbajtura fizikisht.


11. Ligjératat online kanë zhvilluar aftësitë e mia njejtë me ligjératat e mbajtura fizikisht



ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË


Diagrami i dymbëdhjetë shpreh në përqindje orët e studimit në shtëpi ose bibliotekë për lëndë, ku pjesa më e madhe dy të pestat e studentëve kanë studuar 3-4 orë, pak më pak se një e treta 1-2 orë, më pak se një e pesta 5-6 orë dhe gati një e dhjeta mbi 7 orë.

12. Për të arritur sukses përveç ligjëratave dhe ushtrimeve, sa orë në javë keni studiuar dhe jeni përgatitur në shtëpi ose bibliotekë për këtë lëndë?




Diagrami në vijim, i trembëdhjeti me rradhë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me pyetjen nëse testet janë mbajtur ashtu si ka qenë e planifikuar në syllabusin e lëndës, ku pjesa më e madhe e studentëve janë përgjigjur me PO.

13. Testet janë mbajtur ashtu si ka qenë e planifikuar në syllabusin e lëndës




Diagrami i rradhës, shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me përcaktimin e lëndëve zgjedhore ku pjesa më e madhe e tyre janë përgjigjur se kanë qenë te lirë që vetë të përcaktohen përlëndët zgjedhore.

14. Studentët janë të lirë që vetë të përcaktohen përlëndët zgjedhore



Tutje, diagrami i pesëmbëdhjetë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me pyetjen nëse puna laboratorike mbikqyret nga mësimdhënësi/asistenti i lëndës, ku pjesa më e madhe janë përgjigjur me PO.


15. Puna laboratorike/praktike mbikqyret vazhdimesh nga mësimdhënësi/asistenti i lëndës



ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË


Diagrami i gjashtëmbëdhjetë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me respektimin e orarit të konsultimeve nga profesorët. Shumica e studentëve janë përgjigjur se profesorët e respektojnë orarin e konsultimeve.

16. Profesorët/asistentët e respektojnë orarin e konsultimeve




Diagrami i shtatëmbëdhjetë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me pyetjen nëse mësimdhënësit i kanë përcjellur materialet e ligjératave në sistem apo në email, ku shumica prej tyre janë përgjigjur me PO.

17. Mësimdhënësi/ja i ka dërguar të gjitha materialet e ligjératave në SMU apo email




Tutje, diagrami i tetëmbëdhjetë shpreh përqindjen e përgjigjeve të studentëve lidhur me pyetjen nëse mësimdhënësit kanë sqaruar syllabusin e lëndës dhe e kanë shpërndarë me kohë te studentët, ku shumica e tyre janë përgjigjur me PO.

18. Mësimdhënësi/ja e ka sqaruar syllabusin e lëndës dhe e ka shpërndarë me kohë te studentët




Diagrami i nëntëmbëdhjetë shpreh përqindjen e përgjigjeve të studentëve lidhur me pyetjen nëse kanë poseduari paisje për të ndjekur mësimin online, dhe shumica e tyre janë përgjigjur me Po.

19. Kam pasur paisje për të ndjekur mësimin online (telefon, llaptop, kompjuter)




Diagrami i njëzetë me rradhë, shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me pyetjen nëse kanë pasur qasje në internet për të ndjekur mësimin online, ku shumica e tyre janë përgjigjur me Po.

20. Kam pasur qasje në internet për të ndjekur mësimin online




Diagrami i rradhës shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me pyetjen nëse mësimi online duhet të vazhdojë edhe në raste specifike gjatë vitit akademik ku shumica e studentëve janë përgjigjur me PO.

21. Mësimi online duhet të vazhdojë edhe në raste specifike gjatë vitit akademik



Diagrami i fundit, shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me pyetjen nëse do të mund të zgjidhni përsëri a do të registroheshit prapë në të njejtin program ku shumica e tyre janë përgjigjur me PO.

22. Nëse do të mund të zgjidhni përsëri tani, a do të regjistroheshit prapë në të njejtin program të studimit?



23.

KOMENTE:

[Pjetje jo e detyrueshme.](#)

[Përgjigje e shkurtër tekstuale.](#)

[\(1171 përgjigje të postuara\)](#)

Komente:

Studentët në përgjithësi kanë dhënë komente pozitive për gjithë procesin e ligjératave, ushtrimeve, proceseve në UIBM dhe kanë vlerësuar gjithë menaxhmentin e fakultetit që kanë bërë një punë shumë të mirë në gjithë organizimin e mësimit. Ata kanë inkurajuar mësimdhënësit në vazhdimin e përkushtimit dhe motivimit të tillë për studentë duke pasur interaktivitet gjatë ligjératave dhe duke vlerësuar çdo mendim.

Rekomandimet

Zyra e cilësisë në UIBM, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e studentëve të nivelit Bachelor në Fakultetin Juridik dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të UIBM që të merren hapat si më poshtë:

- Fakultetet inkurajohen të eksplorojnë mjediset e të nxënënit virtual përmes mësimit online.
- Të investohet vazhdimesh në trajnime të stafit akademik për metoda të mësimdhënies;
- Stafi akademik dhe fakultetet të shqyrtojnë fokusimin e përbajtjeve akademike edhe në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të studentëve gjatë mësimit online.
- Njësitë akademike të mundësojnë nënshkrimin e sa më shumë marrëveshjeve për punë praktike për studentët;
- Të arrihen sa më shumë marrëveshje me IAL-të tjera, vendore dhe ndërkombëtare për të mundësuar mobilitet të studentëve;
- Të shqyrtohet mundësia e kombinimit të mësimit, online dhe atij fizik, me synimin e ruajtjes së ekuilibrit të ngarkesave akademike për studentët dhe personelin akademik.
- Krijimi i një shumëllojshmërie të aktiviteteve për të krijuar mjedise efektive të të mësuarit.